Projekti parashikon punimet që do të kryhen për spostimin e linjës 6 kV të fiderit “Tharëse” që del nga N/ST 35/6 kV Fieri 1 në pronësi të OSHEE. Ky fider ndodhet brenda gjurmës së zgjerimit të sheshit të N/ST TEC Fier në të cilin do të implementohet projekti “Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri – Maqedonia e Veriut (Fier-Elbasan-Qafë Thanë)”, ku del i nevojshëm spostimi për të liruar sheshin duke i kthyer kampatat të cilat do të zhvendosen nga ajrore në linjë kabllore.

1.1.2 Objekti i Punimeve

- A. Demontimi i linjës ajrore 6 kV të fiderit “Tharëse” ne kampatat midis shtyllave 1-8 sipas projektit bashkelidhur.
- B. Vendosija e dy shtyllave te reja ne dy ekstremitetet ku do te montohet linja kabllore.
- C. Ndertimi i kanalit te kabllit i cili do te mundesoje lidhjen e dy ekstremiteteve te spostimit te linjes ajrore.
- D. Shtirirja e kabllit 6 kV si dhe realizimi i te gjitha punimeve elektrike te nevojshme (instalim thike ndaresi 6 kV, montim i terminaleve te kabllit, montim i shkarkusave, instalim i tokezimit etj.)

Kontraktori eshte i detyruar te siguroje plotesimin e objektit te kontrates dhe per punimet e paparishikuara te lejohet perdorimi i fondit rezerve, deri ne 5%, referuar kritereve te percaktuara ne ligjin nr. 8402, dt.10.09.1998 (i përditësuar), “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”

Komponentet dhe paisjet baze qe, duhet te furnizohen nga kontraktori jane:

- | | | |
|---|------|-----|
| • Furnizim/Vendosije shtylla beton arme cent 10/10 m/kN, 180/320d1/d2 | cope | 2 |
| • Furnizim/Vendosije tranverse metalike me 6 izolatore | cope | 2 |
| • Furnizim/Vendosije ndares linje, TM 6 kV, 3 polar,400A,20KA i jashtem | cope | 1 |
| • Furnizim/Vendosije koke kablli terminale 6-10 kV | cope | 2 |
| • Furnizim/Vendosije kabell Al 6/10 kV, 3x70mm ² | ml | 510 |
| • Furnizim/Vendosije shkarkuesa ventil TM 6-10 kV | set | 2 |
| • Furnizim/Vendosije, dhe punimet e tjera te nevojshme per spostimin e linjes | | |

Kontraktori do te kryeje komisionimin, testimin e te gjitha paisjeve, vendosjen ne pune si dhe energjizimin e tyre.

1.1.1 Kanali i kabllit TM, 6 kV

Punimet per kanal in e kabllave te tensionit 6kV, do te zbatohet sipas kushteve teknike te zbatimit per kete kategori linjash kabllore (linje TM 6kV).

Kanali do te germohet me makineri (ekskavator) ne dimensionet dhe nivelin e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instruksionet me shkrim te Mbikqyresit te Punimeve.

Para fillimit të gërmimit të kanalit, piketohet traseja e kanalit ku shtrihet kablli 6 kV.

Sipas kushteve teknike te projekt-zbatimit, kablli 6kV, pas germimit te kanalit, shtrihet mbi nje shtrese rëre të pastër (rërë e larë) të ngjeshur me $t = 10$ cm.

Me shtrirjen e plotë të kabllot mbi këtë shtresë, hidhet shtresa e dytë me rërë të pastër (*pa kum dhe mbeturina të tjera*) me $t = 20$ cm, pas ngjeshjes.

Për mbrojtjen e shtresave stabilizuese të kabllot, parashikohet shtrimi i tullave në pozicionin ratë në të gjithë gjatësinë e kanalit.

Mbi shtresën e tullave, hidhet materiali i nxjerrë nga germimit i kanalit. Shtresë kjo që ngjeshet me kujdes me tokmak elektrik (ose auto).

Dherat e tepërta të germimit të kanalit, evadohen me mjet transporti në vend-depozitim të miratuar për hedhjen e materialeve të ndërtimit.

1.2 Punime elektrike

1.2.1 KABLLOT E FUQISE TM 6,10KV ME TRE DEJE

1. Pershkrim,kerkesa dhe te dhena

Kablli duhet te jete i perbere nga tre deje me percjelles te perdredhur alumini me presim tre-shtresor (ekrani gjysempercues mbi percjelles, izolimi XLPE dhe ekrani gjysempercues mbi izolim duhet te prodhohen ne nje proces te vetem pune), rrjeta ekranizuese baker, shtrese johigroskopike, veshja e jashtme polietileni. Seksioni nominal I percjellesit(dellit) te fazes 35-240 mm² te pershtatshme per perdorim ne rrjetin e shperndarjes. Ne kushte normale shfrytezimi, kablli me izolacion XLPE punon me temperature maksimale te percjellesit 90 oC.

Te dhena teknike 70 mm²

1.Lloji

Kabell Al tre dejesh me izolim XLPE dhe mbulesa te jashtme PE

Tensioni nominal U_0/U kV 10

Vlera maksimale e tensionit (U_m) kV 12

Vlera nominale e tensionit impulsive qe duron kV 70

Tensioni qe duron ne frekuence te fuqise 50 Hz kV 28

Numri I fazeve 3

Frekuenca Hz 50

Materiali ipercjellesit Alumin

Seksioni I percjellesit(dellit) mm² 70

Materiali izolues XLPE

Shtresat e gjysempercjesit

(metodat e aplikimit)

· Siper percjellesit

· Siper izolimit

I stampuar

I stampuar

Mbulesa metalike mm² 3 16 (baker)

Rryma ne lidhje te shkurter e rrjetes ekranizuese te bakrit kA³ 8

Materiali I mbuleses se jashtme PE

Mbrojtja kunder lageshtise

Gjatesor I pa pershkrushem nga uji

Rryma e lejuar per temperature te percjellesit 65 oC per shtrirje ne toke me vendosje A 175/210

Rrymat e lejuara ne tabelat e me sipërme jane per kushtet e me poshtme:

- thellesia e vendosjes se kabllit 1 m,
- temperatura e ajrit te ambientit 35 oC,
- temperatura e tokes 20 oC,
- rezistenca termike e tokes (ground thermal resistivity) 1 K.m/Ë

Te dhenat e instalimit

Kushtet e instalimit Direct ne toke

Thellesia e vendosjes m 1 - 1.5

2. Standartet referuse

Kabllot TM nentokesor te fuqise duhet te prodhohen konform standarteve IEC ose ekuivalentet e tyre

IEC 183 “Guide to the selection of high voltage cable”

IEC 228 “Conductor of Insulated Cables”

IEC 287 “Electric cables. Calculation of the current rating”

IEC 502 “Extruded solid dielectric poëer cables for rated voltages from 1kV up to 30 kV”

IEC 230 “Impulse tests on cables and their accessories”.

IEC 811 “Common tests methods for insulating and sheathing materials of electric cables”.

IEC1238 “Compression and mechanical connectors for poëer cables ëith copper or aluminum conductors”

IEC 60228 Conductors of insulated cables.

IEC 60287 Electric cables - Calculation of the current rating.

IEC 60332 Tests on electric cables under fire conditions.

IEC 60502 Poëer cables ëith extruded insulation and their accessories for rated voltage from 1kV (Um=1,2kV) up to 30 kV (Um=36kV)..

3. Ndertimi dhe materiali

Kablli me tri deje duhet te jete I perbere nga alumin shumefijesh I perdredhur kompakt I klases 2 sipas IEC 60228.

Kablli duhet te jete I perbere nga tre deje me percjelles te perdredhur alumini te klasas 2 me presim treshtresor (ekrani gjysempercues mbi percjelles, izolimi XLPE dhe ekranin gjysempercues mbi izolim duhet te prodhohen ne nje proces te vetem pune), rrjeta ekranizuese baker, shtrese johigroskopike, veshja e jashtme polietileni (sipas fig.1) Ekranimi I percjellesit, izolimi XLPE dhe ekranimi i izolimit duhet te stampohen ne nje proces (hap) te vetem pune dhe te ngurtesohen nepermjet procesit ngurtesim i thate (dry-curing). Kabli duhet te jete i pershtatshem per shperndarjen e energjise elektrike. Prandaj ai duhet te pergatitet me nje guarnicion gjatesor dhe alternative gjatesor dhe radial per mbrojtjen nga uji pergjate ekranit metalik. Guarnicioni gjatesor duhet te pergatitet nga nje shrese zgjeruese e aplikuar mbi ekranin metalik ose nga nje material zgjerues i vendosur midis percjellsave te ekranit metalik. Guarnicioni radial duhet te pergatitet nga nje metal rezistent ndaj korrozionit ose metal-polietilen i petezuar I aplikuar mbi guarnicion. Kujdes I vecante kerkohet per tu shmangur korrozionin galavanik. Eshte thelbesore qe guarnicioni te mbetet efektiv ,nqs nje pjese e demtuar zevendesohet me ndihmen e muftëve ne nje gjatesi te re. Kabli duhet te jete konstruktuar ne perputhje me standartet nderkombetar IEC dhe ne vecanti me rekomandimet e IEC 60502-2 .

Kablote duhet te jene te afte te punojne ne temperature te vazhdueshme pune maksimale prej 90 °C dhe duhet te jene te prodhuar per instalim direkt nen toke, por mund te perdoren edhe ne ambiente te brendshme ose ne tubacione nen toke sipas kushteve te terrenit. Percjellesit prej alumini duhet te jene te

shkalles 100% pasterti te grades elektrike ne perputhje me standartet nderkombetare. Veshja e jashtme duhet te jete prej polietileni PE me densitet mesatar, me nje qendrueshmeri ne terheqje prej 18 N/mm² dhe nje zgjatim minimal prej 300% kur testohen sipas IEC 60811-1-1. Kablot me mbulesë polietileni PE duhet te jene te pershtatshem per temperature minimale instalimi -10°C.

4. Shenime

Kablote TM duhet te jene shenimet te stampuara ne menyre te paheqeshme.

Ne kablo duhet te jene shenimet e meposhtme:

- OSHEE
- Seria e prodhimit
- Standartet referuese
- Shenimi qe identifikon numrin serial dhe vitin e prodhimit
- numri, seksioni dhe materiali I percjellesit
- tensioni I izolimit
- lloji I materialit izolues
- marketim CE
- Shenimi I gjatesise progresive , qe duhet te filloje me vleren me te madhe meqellim qe

gjatesia e kabllit te mbetur ne baraban te kete mundesi per tu lexuar.

Shenimi do të ketë permasa të mjaftueshme për t'u lexuar në raport me diametrin e kabllit. Hapësira ndërmjet dy shenimeve të njëpasnjëshme nuk do t'i kalojë 50 cm.

Kablli duhet të jetë i pajisur me shirita të vazhdueshëm në ngjyrë të kuqe, të verdhe dhe blu për përcaktimin e fazave gjatë montimit.

5. Testet

a) Testet rutine

Testet rutine duhet të behen në të gjithë gjatësinë e kabllit për secilin lloj dhe seksion.

Testet rutine behen sipas kërkesave të standartit IEC 60502-2

- Matja e rezistencës elektrike të përcjellesave. Vlera e matur e rezistencës duhet të jetë korrekte në temperaturën 20°C dhe në 1 km gjatësi në përputhje me formulat dhe faktoret e dhënë në IEC 60228

- Testi i rrymave të rrjedhjes (Partial discharge) në 1.5 U₀, dhe vlera maksimale e lejuar do të jetë 5 pC. Nuk do të pranohen kabllot me rryma rrjedhjeje më të mëdha.

- Testi me tension të rritur AC : për 2.5 x U₀, në 50 Hz, për 15 minuta

b) Testet Speciale:

Testet e mëposhtme speciale duhet të kryhen sipas standartit të mesiperm

- Ekzaminim i përcjellesit

- Kontroll i dimensioneve

- Testet elektrike

- Testi në nxehtësi (Hot set test) i izolacionit XLPE

c) Testet tip

Te gjithë testet tip, elektrike dhe jo-elektrike, të aplikueshme në kabllot 10 dhe 20 kV me izolacion XLPE të specifikuar sipas standarteve përkatës, duhet të kryhen në rast se prodhuesi nuk paraqet një certificate për testet tip për kabllot të ngjashëm që janë testuar gjatë 5 viteve të fundit

d) Prova për depërtueshmëri dhe uji

Për më tepër testet e mesiperm duhet të përfshijnë edhe proven për mbrojtjen nga lageshtira sipas IEC 60502-2, Aneksi D. Prova për mbrojtjen nga lageshtia duhet të jetë bërë edhe nga firma prodhuese.

6. Identifikimi dhe paketimi

Kabllot duhet të levrohen në barabane të gatshme për tu shtruar në trase. Skajet e kablove në baraban duhet të jenë të mbrojtur ndaj depërtimit të ujit dhe lageshtisë. Ato duhet të mbyllën në mënyrë të tillë që gjatë qëndrimit për kohë të gjatë në magazine, kabllot të jenë të mbrojtur ndaj rrezatimit të diellit.

. Regjistrimi I tij duhet të fillojë me shenimin më të gjatë që në gjatësinë e kabllit të mbetur në baraban

te kete mundesi per tu lexuar. Perafersisht 250 m e tri fazeve te kabllit duhet te mblidhen ne nje baraban. Bleresi duhet te specifikojte gjatesine e sakte ne kohe. Barabanet duhet te jene qendrueshmerine per ti rezistuar transportit gjate shtrirjes se linjes ne rrejet.

Ne secilin baraban duhet te jete shenuar:


- Lloji I kabllit
- Gjatesia e kabllit
- Emri I prodhuesit
- Viti I prodhimit
- Pesha bruto marketimi CE

Barabanet bosh nuk rikthehen.

7. Informacioni I kerkuar teknik

- Mbushja e skedulit te te dhenave
- Skica per seksionin terthor te kabllit
- Padeptueshmeria e ujit, pershkrim
- Vetite konstruktive
- Padeptueshmeria e ujit ,procedurat e testeve

Aneks 1 (kerkesat minimale)



- 1- Percjelles shumefijesh i perdredhur Al
- 2- Shtresa gjysempercuese ne percjellesin e fazes
- 3- Izolimi XLPE
- 4- Shtresa gjysempercjellese mbi izolacion
- 5- Ekrani shirit bakri
- 6- Shtresa johigroskopike (kunder lageshtise)
- 7- Veshja e jashtme PE

1.2.2 SHKARKUESIT METAL-OKSID TE TM 6KV

1. Te pergjitheshme

Ky specifikim mbulon kerkesat per prodhimin, furnizimin, testimin dhe shperndarjen e shkarkuesave metal-oksid te TM 6kV, qe perdoren per mbrojtjen e linjave elektrike te shperndarjes.

Ky specifikim perfshin::

- Shkarkuesit metal-oksid te TM 6 kV

Ilustrimi



1. Varistori ZnO, (Oksid Zinku)
2. Veshja prej silikoni Boëthorpe silicone housing
3. Struktura rezistente ndaj zjarit
4. Bazamenti I perbere nga aliazh alumini /Pjesa fiksuse prej celiku te pa ndryshkshem

2.Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat me dimensione
- Manual perdorimi

3. Kushtet e Sistemit

a Specifikime Njesia Vlera

1 Tensioni nominal ne sistem	kV	6
2 Tensioni me I larte ne sistem	kV	7.2
3 Frekuenca e sistemit	Hz	50

4 Numri I fazeve	Jo	3 faze
5 Sistemi I tokezimit I izoluar		
b Kushtet atmosferike		
1 Temperatura maks. e ambientit		40oC
2 Temperatura minimale e ambientit		-10 oC
3 Lageshtia relative maks		80%
4 Lartesia maksimale mbi nivelin e detit		1000m
5 Ndotja		mesatare

4. Pershkrimi, Kerkesa, Te dhena

Shkarkuesit metal-oksid te TM 6kV prodhohen duke perdorur Varistor prej oksid Zinku ZnO , te cilet kane karakteristika te mira termike.

Zemra e shkarkuesave elektrike duhet te jete me disqe me oksid zinku , ndersa veshja e jashtme prej polimeresh.Te gjithë pjesët metalike ne ajër duhet te jene te zinkuara ne te ngrohete, çelik i pandryshkshem ose derdhje alumini. Materiali i rezistoreve duhet te jete prej Oksid Zinku.

Trupi i shkarkuesit duhet te jete i ndertuar me materiale polimere dhe te mos demtohen nga harku.

Shkarkuesi duhet te jete rezistent ndaj ndotjes se ambientit ku do te vendoset si avuj uji , pluhura natyror, reres dhe ndotjeve industriale.

Aksesoret e montimit dhe te lidhjes do te jene pjese perberese e shkarkuesit.

Ambienti	I jashtem
Kushtet e perdorimit sipas SSH EN 60099-4 (IEC 60099-4 ed.2)	Normal

Parametrat e rrjetit te TM te shperndarjes:

Tensioni nominal 6 000 V

Tensioni me I larte I rrjetit 7 200 V

Frekuenca 50Hz

Numrui I fazeve` 3

Tipi I lidhjes se pikes neutrale:

- IT Shumica e rrjeteve te TM
- IT(r) Vetëm rrjetet kabllore ne qutetet e medha
- Kohe zgjatja maksimale e difektit 2 ore
- Vlera maksimale e mbitesionit te perkohshem
- (lidhje tokesore) 7.9 kV per 2 ore

Niveli I izolimit

Qendrueshmeria ndaj tensionit nominal 15 kV

Qendrueshmeria ndaj tensionit imp.

te shkarkimeve atmosferike. 37.5 kV

Rryma e lidhjes se shkurter te shkarkuesit

Rryma max. e lidhjes se shkurter tre fazore 20 kA

Kërkesat për shkarkuesin në aspektin e vendit brenda sistemit:

Lidhur me sistemin: ndermjet fazes dhe tokes

Lloji i paisjeve te mbrojtura:

Linjat ajrore dhe kabllore te TM

Daljet e kabllore te TM(ne piken e tranzicionit te linjes ajrore ne kabllore)

- Kabllot e TM(ne pikat e degezimit te linjave ajrore dhe kabllore)

Trasformatoret TM/TU, TL/TM, reaktoreve(i lidhur direkt ne kabllin e TM)

Paisjet e tjera te N/stacioneve TM/TU dhe TL/TM(Ne hyrje te tesionit te larte

Te dhena teknike

Qendrueshmeria ndaj tesionit te impulsit atmosferik 1,2 / 50 mikrosekonda 60kV

Qendrueshmeria ndaj tesionit(1 min, 50 Hz) ne lageshtire 24kV

Shkalla e shkarkimeve te pjeseshme ne 1.05 Uc $\leq 10\text{pC}$

Materiali I rezistences jolineare(varistorit) oksid zingu

Materiali per izolues i shtreses se jashtme (ne perputhje me shtojcen 2. te SSH EN 60099-4) Polimer

Materialet e aksesorevel ndryshkshem alumini/celik i pa

Forca ne terheqje 2 kN

Forca ne rotullim 50 Nm

Forca ne perkulje(ne perputhje me nenin 13.7.2 ndryshimet

A2 SSH EN 60099-4 dhe ne pajtim me nenin 10.8.9 SSH EN 60099-4 ed.2)

350 Nm

Tesioni operativ i vazhdueshem Uc 7.2 kV

Qendrueshmeria ndaj tesionit Ur 9kV

Qendrueshmeria ne shkarkimet nominale In(8/20 μs) 10 kA

<input type="checkbox"/> Rryma me e larte impulsive (4/10 μ s)	100 kA
<input type="checkbox"/> Klasa e shkarkimit (klasa e energjise)	1
<input type="checkbox"/> Forca e lidhjes se shkurter ne 0.2 s	25 kA
<input type="checkbox"/> Tesioni maksimal i mbetur ne $I_n=10$ kA –vlera maksimale	25 kV
<input type="checkbox"/> Ryma e qendrushmerise per impuls te gjate 30/60 μ s	350 A
<input type="checkbox"/> Tesioni me I larte I perkohshem sipas SSH EN 60099-4 Aneksi D	
<input type="checkbox"/> Per kohe 100s	9.9 kV
<input type="checkbox"/> Per kohe 2 ore	9.4 kV
<input type="checkbox"/> Gjatesia minimale e ruges se rrymave te rrjedhjes	228 mm
<input type="checkbox"/> Gjatesia pa paisje	95 mm
<input type="checkbox"/> Pesha	1 kg

5. Kerkesa Shtese

Shkarkuesi I TM 6 kV duhet te kete te mbishkruar:

- Emri ose marka e prodhuesit
- Tensioni nominal, kV
- Rryma nominale e shkarkimit, kA
- Viti I prodhimit
- Markim CE

Keto mbishkrime duhet te jene te lexueshme qarte dhe te mos fshihen nga kushtet atmosferike

6. Aplikimi

Shkarkuesit e TM 6kV rekomandohen per mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike dhe vala e mbitensioneve ne zonat me nivel te larte shkarkimesh

7. Rajoni I aplikimit

Shkarkuesit e TM 6kV perdoren ne te gjithë vendin

8. Paketimi

Shkarkuesit e TM 6kV paketohen ne kuti kartoni.

Ne cdo kuti duhet te shenohet informacioni I me poshtem

- Emri I prodhuesit
- Numri I kontrates
- Numri I Urdherit te Blerjes

-
- Tipi I shkarkuesit
 - Numri I shkarkuesave
 - Pesha (kg)
 - Markim CE

9. Standartet Referuese

- SSH EN 60099-4- shkarkuesit- pjesa 4 perfshire ndryshimet A1 dhe A2
- SSH EN 60099-4 ed.2-shkarkuesit- pjesa 4 perfshire ndryshimin A1
- SSH EN 60099-5 –shkarkuesit- pjesa 5 perfshire ndryshimin A1

10. Inspektimi dhe Testet

Shkarkuesit e TM 6kV duhet te testohet ne perputhje me Standartin IEC60099-4

Tipet e Testeve

Tipet e testeve do te behen ne perputhje me standartet IEC ose standarteve ekuivalente me to.

Ne qofte se zoterohen certificata te testeve te kerkuara, te bera nga nje laborator i pavarur ne perputhje me keto specifikime, ato mund te pranohen ne vend te testeve te kerkuara.

Testet Rutine

Ne testet rutine do te perfshihen:

- Testi tensionit referuar frekuences industriale
- Testi I tensionit te mbetur
- Mungesa e shkarkimit te pjesshem dhe zhurma e kontaktit
- Testi qendrushmerise termike

Testet e Pranimi

Testet e me poshtme standarte te pranimi do te kryhen ne tre shkarkues:

- Testi I tensionit me frekuence nominale
- Testi i qendrushmerise ndaj tenseve impulsive per kohe te gjate
- Testi I shkarkimit te pjesshem

1.2.3 NDARESAT E JASHTENM TE TM (PER TRE FAZE)



1.1 Kerkesa te pergjitheshme

Ky specifikim percakton kushtet e pergjitheshme teknike per blerjen dhe pranimin e ndaresave te jashtem tre fazore te TM.

Produkti do te prodhohet dhe kontrollohet ne perputhje me standartet IEC ose standarte te tjera ekuivalente me te.

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



1.2 Kërkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe Ofertuse/Furnizuesi duhet te paraqese si pjese integrale e ofertes/furnizimit, dokumentat e me poshtme:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat me dimensione
- Manual instalimi
- Manual perdorimi
- Te kene markim CE

1.3 Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin	Njesia	
Tensioni me i larte per paisjet	kV	12
Tensioni nominal	kV	10
Frekuanca	Hz	50
Numuri I fazeve	Nr	3 faze
Sistemi I tokezimit		I izoluar

Kushtet atmosferike

Temperature Max. e ambientit 40oC

Temperature Mi. e ambientit -10 oC

Lageshtia relative maks 80%

Lartesia maksimale mbi nivelin e detit 1000m

Ndotja Mesatare

1.4 Pershkrim, kerkesa dhe te dhena

Ndaresat e jashtem tre fazore jane projektuar per te hapur dhe mbyllur qarkun elektrik (te tre fazet njeheresh) ne gjendjen pa ngarkese. Ne gjendje te hapur ata duhet te bejne nje hapësire izolimi te dukshem dhe te sigurte.

Ndaresat duhet te perdoren ne ambiente te jashtme, ne kushte klimatike te buta dhe temperature te ambientit nga -10°C deri +40°C. Instalimi i paisjes ne kushte te tjera mjedisore duhet te behet ne mareveshje me prodhuesin.

Ndaresi eshte i paisur me nje leve mekanike manuale per komandimin e saje. Parashikohet edhe perdorimi i çernjeres dyfishe. . Gjatesia e leves rregullohet nepermjet tubave me gjatesi te rregullueshme te cilat jane pjese e funizimit te ndaresit. Gjatesia totalee tubave (minimumi 6 m)

Parashikohet edhe doreza e izoluar.

Te gjitha pjeset metalike jane te galvanizuara ne te nxehte.

Ndaresi duhet te perballoje rrymat nominale per nje kohe te gjate pa nxehtjen e kontakteve mbi temperaturen e lejuar. Gjithashtu kontaktet nuk duhet te saldohen ose te pesojne ndonje demtim tjeter nga rrymat e lidhjes se shkurter te difektit.

Ndaresi prodhohet per perdorim manual.

Ndaresi paiset me nje mekanizem te ruajtjes se energjise per ckycje te shpejte.

Korniza baze e ndaresit duhet te jete me zing te praruar dhe e kromuar.

Pjeset percjellese te rrymes duhet te jene te galvanizuara me argjend te praruar.

Boshti operativ duhet te kete opsionin per perdorim majtas osr djathtas.

Izolatoret

Te gjithë izolatoret do te jene per perdorim te jashtem conform standarteve IEC Nr. 60168

Technical data

Tesioni nominal	kV	10
Frekuenca nominale	Hz	50
Rryma nominale	A	400
Rryma per kohe te shkurter	kA	20
Koha nominale per qendrushmeri ne LSH	s	1

Shenim

Ndaresi duhet te jete i paisur me leven operuese, tubat zingato (1" per tension deri 20 kV dhe 1e3/4 per tension 35 kV) me gjatesi 6 m, cernierat dhe dorezen. Tubat dhe gjatesia e tyre jane pjese e negociushme ne fazen e pyetjeve te tenderit.

1.5 Standartet referuse

Ndaresat e jashtem tre fazore prodhohen ne perputhje me standartet me te fundit:

- SSH EN. 60060 Teknika të provës në tension të lartë ("High-Voltage Test Techniques")
- SSH EN IEC. 60071 Koordinimi i izolimit("Insulation Coordination"
- SSH EN 62271-102 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë - Pjesa 102

Stakuesit e rrymës alternative me tension të lartë dhe çelësat e tokëzimit (Highvoltage sëitchgear and controlgear - Part 102: Alternating current disconnectors and earthing sëitchses

- SSH EN. 60168 Prova mbi izolatorët mbështetës për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm prej qeramike ose xhami për sisteme me tension nominal me të madh së 1 kV ("Tests on Indoor and Outdoor Post Insulators for Systems ëith Nominal Voltage greater than 1'000 V" Ose ekuivalentet e tyre

1.6 Aplikimi

Ndaresat e jashtem tre fazore perdoren ne kabinat e trasformimit TM/TU shtyllore.

1.7 Inspektimet dhe testet

Testet tip

Testet tip duhet te behen ne perputhje me standartet me te fundit IEC si psh IEC 60265-1 Ne qofte se ofertuesi sjell teste tip te leshuara nga nje laborator i pa varur per kete material, ato mund te pranohen ne vend te testeve te tilla.

Testet qe kerkohen jane:

- Testi dielektrik ne qarqet kryesore e ndihmese
- Testi qendrushmerise ne frekuencen e fuqise, per 1 min
- Testi qendrushmerise ndaj impulsev te shkarkimeve ,1.2 x 50 µsec
- Testi ritjes se temperatures
- Qendrushmeria ndaj operimeve mekanike

Testet rutine

- Testi dielektrik ne qarqet kryesore
- Testi dielektrik ne qarqet ndimese

- Matja e rezistences ne qarkun kryesorx`
- Testet mekanike te operimit ne 50 cikle operative

1.2.4 SPECIFIKIME KOKA(TERMINALE) KABLLI TM

Te pergjithshme

Te gjitha terminalet e kabllit 10, 20, 35kV jane projektuar qe te jene te sigurta ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime.

Terminalet e kabllit 10, 20, 35kV duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale.

Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001 ose ISO 9002
- Te dhena teknike si ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat dhe dimensionet
- Manual I perdorimit
- Te kene marketim CE

Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	Sistemi 10/20/35
kV		
Tensioni nominal ne sistem	kV	10/20/35
Tensioni me I larte ne sistem	kV	12/24/38.5
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri I fazeve		3
Sistemi I tokezimit		I izoluar

Kushtet atmosferike

Temperature maksimale e ambientit 40 °C

Temperatura maks. mesatare ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maks. ne sipërfaqet e ekspozuara ne diell	60 °C
Lageshtia relative maks (ne toke)	95 %
Lageshtia relative maks (ne ajër)	80 %
Lartësia maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

Testet fizike dhe elektrike duhet te jene ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre. Materialet duhet te jene sipas standartit ISO 9001 ose nje standart me i avancuar.

Standartet referuese

Terminalet e kabllit nje dhe terfaze 6, 10, 20, 35kV duhet te jene conform kerkesave te standartit CENELEC HD 629, EN 50180, IEC 137 ose ekuivalentet e tyre.

Testet

Testet duhet te kryhen ne perputhje sic specifikohet ne standartin CENELEC HD 629, IEC 61442 ose standarte te tjera ekuivalente.

Identifikimi dhe paketimi


Paketimi duhet te jete I projektuar ne menyre te tille qe te mbroje mallin nga hyrja e ujit dhe demtimet mekanike. Te gjitha pjeset perberese duhet te ruajne parametrat teknike ne temperaturat -5oC deri 40 oC. Cdo koke kablli te duhet te kete brenda ambllazhimit udhezimet e instalimit, aplikimin, diapazonin e perdorimit si dhe emertimin dhe sasine e pjeseve perberese. Emertimet, diapazoni, emri firmes prodhuese duhet te jete i stamposur mbi cdo pjese perberese.

A. KOKA KABLLI PER KABLLO TE EKSPANIZUAR TRE FAZORE (3 DEJESH) ME IZOLIM POLIMER 10-20-35 kV

1. Terminale te jashtme 10 - 20 - 35 kV

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrim

Kabli duhet te transformohet ne pothuaj tre deje kabli te cilat lejojne kryqezimin e dejeve madje dhe ne hapesirat e mbyllura te lidhjes. Dejet duhet te mbulohen me tubin nga siperfaqja ku kabli eshte unik deri te skaji. Ne piken ku dejet ndahen vendoset materiali bllokues dhe ngjites. Trupi I terminalit(I termotkurrshem) duhet te kete nje shtrese kontrolli per te kryer kontrollin e fushes elektrike brenda te gjithë gjatesise se terminalit dhe nje shtrese izolimi ne formen e nje tubi me dy shtresa te stampuara qe ne prodhim per te mos lejuar fluska ajri midis tyre, qe ben te mundur mospasjen e zonave me gradiente te larte te fushes elektrike . Ngjitesi termoshkrires me shkrirjen e tij hermetizon skajet e kablit me gushoren nga lageshtira dhe papastertite. Gushorja ben hermetizimin e gjithë kabllit. Kapikordat ne forme syri duhet te jene prej materiali bimetalik (Al-Cu) dhe te jene brenda kompletit. Me kerkese te vecante ku percaktohet dhe materiali Cu-Al ose Al, kapikordat mund te jene edhe ne forme kunj.

Konstruksioni i terminaleve te jashtme duhet te shoqerohet me izolatorete(fustanella) qe instalohen mbi tubin e jashtem izolues. Bashkueset per tokezim per kabllot me armim duhen porositur te ndara. Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet per te tria fazet. Gjatesite e dejeve mund te reduktohen ne varesi te kerkeses se vendit ku instalohen, minimum I gjatesise se dellit eshte 320 mm for $U = 10 \text{ kV}$ 460 mm for $U = 20 \text{ kV}$ and 800 mm for $U = 35 \text{ kV}$.

Perdorimi

Terminalet per ambient te jashtem 10, 20 kV dhe 35 kV jane ndertuar per kabllot te ekranizuar me tri deje me nje veshje te jashtme plastike , te armuar ose jo ose mbrojtese shirit bakri.

1.2.5 TRAVERSA TM 6-10 kV TIP "Y"

1. Te pergjitheshme

Materialet e ofruara duhet te jene te prodhimit standart dhe ne perputhje me specifikimet e me poshtme.

Te gjitha materialet duhet te jene te projektuar per te siguruar funksionim te kenaqshem sipas kushteve atmosferike qe veprojne ne vend, pa deformime, perkeqesim apo ritjen e pa nevojshme te tensionit(stresit) ne cdo pjese. Materialet do te operojne ne kushte te kenaqeshme per ndryshime te ngarkeses dhe tensionit(stresit) dhe te lidhjeve te shkurtera qe mund te ndodhin ne sistem, me kusht qe ato te mbeten brenda vlerave te caktuara te paisjeve. Të gjitha materialet e përdorura në prodhimin e produktit duhet të jene te cilësisë më të mirë dhe të një lloji të përshtatshëm për punën dhe kushtet e specifikuara. Te gjitha materialet e permendura me poshte jane te galvanizuara.

2. Kërkesa te Detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Te dhena teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjithë test raportet e fabrikes
- Skicat dhe dimensionet
- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001 ose ISO 9002

3. Kushtet e Sistemit


Te Dhenat e Sistemit	Njesia	
Tensioni me I larte ne sistem	kV	7.2/12
Tensioni nominal	kV	6/10
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve	Nr	3 faze
Sistemi I tokezimit		Isoluar

Kushtet atmosferike

Temperatura maksimale e ambientit	50oC
Temperatura max. Mesatare ditore	30oC
Temperatura minimale e ambientit	-10 oC
Lageshtia maksimale relative	90%
Lartesia maksimale nga niveli I detit	1500m

A. TRAVERSAT E TM “Y”, PER NJE IZOLATOR PER FAZE

Ilustrimi



Pershkrimi

Traversa "Y" për një izolator për fazë përbehet:

- nga pjesa e drejte me hekur profil "L" 70x70x7mm, me gjatesi 1900 mm,
- Dy pjeset anesore me hekur profil "L" 70x70x7 mm, dhe dy shirita celiku 40x4 mm (qafore)

Ne pjesen e sipërme hapen tre vrima me diameter $\phi=22$ mm për kunjat e izolatoreve. Pjesa e montimit të kunjave perforohet me saldimit me profil "L" 70x70x7 me gjatësi 70mm duke u kthyer në profil □ me brinjë 70x70 mm. Pjesë përberëse e traversës është edhe kokorja në formë "Y" e cila, me anën e saldimit fiksohet në traversën horizontale. Kokorja ka edhe dy fasheta me hekur shirit 40x4mm, që shërbejnë për shtrengimin e traversës mbas shtyllës me anën e dy bulonave M12+dado+rondele që janë pjesë e traversës.

Pamja e jashtme është uniforme dhe e lemuar.

Traversa është e zinguar me një shtresë jo më të vogël se 60 mikron.


Izolatorët dhe kunjat nuk janë pjesë e traversës, ata porositen më vete.

Perdorimi

Traversa "Y" për një izolator për fazë përdoret në linjat ajrore të TM me përcjellesa të cveshur dhe shërben për montimin e izolatoreve të TM në të cilët fiksohet përcjellesi. Ajo vendoset në shtyllat e betonit. Distanca maksimale e kampates 60m.

B. TRAVERSAT E TM "Y", PËR DY IZOLATOR PËR FAZË

Ilustrimi



Pershkrimi

Traversa "Y" për dy izolator për fazë përbehet:

- nga pjesa e drejte me hekur profil "L" 80x80x8mm, me gjatesi 2100 mm,
- Dy pjeset anesore me hekur profil "L" 80x80x8 mm, dhe dy shiritat celiku 40x4 mm (qafore)

Ne pjesen e sipërme hapen gjashtë vrima me diametër $\phi=22\text{mm}$ për kunjat e izolatoreve. Pjesa e montimit të kunjave përforcohet me saldimit me profil "L" 80x80x8mm me gjatësi 70mm duke u kthyer në profil □ me brinjë 80x80 mm. Pjesë përberëse e traversës është edhe kokorja në formë "Y" e cila, me anën e saldimit fiksohet në traversën horizontale. Kokorja ka edhe dy fasheta me hekur shirit 40x4mm, që shërbejnë për shtrengimin e traversës mbas shtyllës me anën e dy bulonave M12+dado+rondele që janë pjesë e traversës.

Pamja e jashtme është uniforme dhe e lemuar.

Traversa është e zinguar me një shtresë jo më të vogël se 60 mikron.

Izolatorët dhe kunjat nuk janë pjesë e traversës, ata porositen më vetë.

Perdorimi

Traversa "Y" për dy izolator për fazë përdoret në linjat ajrore të TM me përcjellës të cveshur dhe shërben për montimin e izolatoreve të TM në të cilët fiksohet përcjellësi. Ajo vendoset në shtyllat e betonit. Distanca maksimale e kampatës 60m

1.2.6 IZOLATORE LINJE 10KV, 8KN

1. Te pergjitheshme

Materialet e furnizuara duhet te jene te prodhimit standart ne perputhje me specifikimet e me poshtme. Te gjitha materialet do te jene te projektuara per te siguruar funksionim te kenaqshem sipas kushteve klimatike qe mizoterojne ne vend, pa ndryshuar,perkeqesuar apo ritur tensionin e panevojshem ne cdo pjese.

Materialet do te punojne ne menyre te kenaqshme per variacione te ngarkeses dhe tensionit , lidhjeve te shkurteraapo kushteve te tjera te sistemit, me kusht qe ato te mbeten brenda vlerave te lejuara te paisjeve. Te gjitha materialet e perdorura ne prodhimin e produkteve duhet te jene te cilesise me te mire dhe ten je lloi te pershtatshem per punen dhe kushtet e specifikuara.

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



2. Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat me dimensione
- Manual perdorimi
- Te kene marketim CE

3.Kushtet e Sistemit

Specifikime	Njesia	Vlera
1 Tensioni nominal ne sistem	kV	10

2 Tensioni me I larte ne sistem	kV	12
3 Frekuenca e sistemit	Hz	50
4 Numri I fazeve	Nr	3 faze
5 Sistemi I tokezimit		I izoluar

b Kushtet atmosferike

1 Temperatura maks. e ambientit		50oC
2 Temperarura max. mesatare ditore		30oC
3 Temperatura minimale e ambientit		-10 oC
4 Lageshtia relative maks		90%
5 Lartesia maksimale mbi nivelin e detit		1500m
6 Shpejtesia maksimale e eres		126 km/h
7 Ndotja		mesatare

Pershkrim, kerkesa dhe te dhena

Material ii izolatoreve duhet te jete porcelan C 110.

Izoloret duhet te garantojne nje qendrushmeri mekanike ne perkulje ne qafen e tyre 8kN.

Izoloret ne pjesen e brendshme duhet te perforcohen me sulfurgrafit si dhe te mbrohen me nje shtrese te holle paste siliconi per mos depertimin e lageshtise.

Ngjyra e izolatoreve duhet te jete kafe e lustruar.

Ne pjesen e jashtme te izolatoreve duhet te stamposet tipi I izolatorit, emir I prodhuesit, tensioni nominal, qendrushmeria ne perkulje ne kN, viti I prodhimit.

Kunji i izolatorit duhet te behet me celik te galvanizuar ne te nxehte, M20 Kunji me dado dhe rondele eshte pjese perberese e izolatorit te furnizuar .

Izolatori transportohet i ndare nga kunji,dadoja dhe rondelja.

Te gjitha pjeset perberese per montimin e izolatorit duhet te prodhohen me te njejtin standart si dhe trupi I izolatorit.

Te gjitha pjeset metalike duhet te mbrohen nga korozioni me galvanizim ne te nxehte.

Testet e izolatoreve duhet te kryhen ne perputhje me standartet SSH EN 60168

Te dhena Teknike

Pershkrimi	Sasia	Vlera
Distanca e izolimit	mm	320

Pesha totale	Kg	2.5
Lartësia totale	mm	166
Lartësia deri ne qendër të qafës	mm	128
Diametri i qafës	mm	80
Diametri i kokës	mm	100
Sforcimi i lejuar në qafë	kN	8
Numri i unazave	cop	2
Tipi i materialit (porcelanit)	- C	110
Tensioni nominal	kV	10
Qendrueshmëria ndaj tensionit të shkarkimeve 1,2 / 50 μ sec	kV	70
Qendrueshmëria ndaj tensionit me frekuencë 50Hz	kV	28
Prova me tension AC në kushte të thata	kV	35
Prova me tension AC në kushte me lagështirë	kV	28
Prova me tension AC në të thatë (për valën +)	kV	78
Prova me tension AC në të thatë (për valën -)	kV	110
Prova me U _{max} , në të thatë	kV	50
Prova me U _{max} , në lagështirë	kV	36

5. Standartet referuese

Izolatorët e TM duhet të jenë në përputhje me Standartin SSH EN 60383-1 , IEC 60273 ose ekuivalente të tyre.

6. Aplikimi

Izolatorët duhet të plotësojnë dy kushte kryesore:

- Mbeshtetja mekanike e përcjellesave të zhveshur në strukturën mbështetëse (traverse).
- Izolimi elektrik i përcjellesave të zhveshur të linjës.

Keta izolatore përdoren për vendosjen e përcjellesave të zhveshur të linjave ajrore me tension 10kV, si për shtyllat ndërmjetese ashtu edhe për shtyllat këndore dhe ankerore brenda qendrueshmërisë së lejuar të tyre. Për më tepër keta izolatore përdoren për mbajtjen e përcjellesave të zhveshur në tipe të ndryshme të konstruksioneve mekanike mbajtëse (traverse) si dhe të tipeve të ndryshme të shtyllave apo bazamenteve mbajtëse metalik. Duhet të projektohen për të punuar jo në sforcim.

7. Montimi

Izolatorët duhet të montohen në gjendje të pastër, jo me yndyrë si dhe ndotje të tjera të sipërfaqes së tyre. Keta izolatore shtrengohen në konstruksionin mbajtës metalik (traverse) me bulon dhe rrota M20.

Gjatesia e bulonit te izolatorit varet nga tipi I konstruksionit mbajtes metalik te tyre. Izolatoret duhet te perdoren ne perputhje me stampen e treguar nga prodhuesi.

8. Kontrolli i cilesise

Izolatoret duhet te jene sipas ISO 9001

Shënime:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 1(nje) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 800,000 (teteqind mijë) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 1,000,000 (nje milion) Leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më të vogël se 4,000,000 (kater milion) Leke.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorite e meposhtme:*

Punime te pergjithshme ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime germimi ne toke	Klasifikim A
Kategoria NP-11	Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	Klasifikim A

Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale duhet te kete te punesuar si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1 (nje) inxhinier elektrik dhe 1 (nje) inxhinier mekanik. Inxhinieret e mesiperme duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperme, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te dëshmoje se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 5 (pese) punonjës me kohë të plotë pune, për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet te jene te siguruar te pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listepagesat perkatese E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues per përmbushjen e kontratës duhet te dëshmoj se ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme, si me poshte vijon:*

Nr	Mjetet	Sasia
1	Eskavator	1 cope
2	Kamioncin	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:

- Per mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi te paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)*
- Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit te bere me lart.*

3. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti dhe certifikaten e pronesisë së mjetit) dhe foto ku te duket qarte targa e mjetit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO, të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- ✓ ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit.
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.

2.3.8 Per listën e mëposhtme të mallrave:

1. Ndarrës linje 3P, TM, 6kV, 400A, 20KA i jashtëm;
2. Shkarkues Ventil TM 6-10 KV;
3. Kabllo Al 6/10kV (3x70) mm² EPR;

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit, për listën e materialeve të mësipërme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike baze të përthyerë në gjuhën shqipe.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë e katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

2.3.9 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Atesë, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuara të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim:

- i. *Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*
